



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

**SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË  
DETYRË/PRANIM NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL KATEGORINË E  
ULËT DREJTUESE**

Lloji i diplomës “Shkenca Ekonomike-Financë”

niveli minimal i diplomës “Master Shkencor”

Në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar, Autoriteti i Mediave Audiovizive shpall procedurat për plotësimin e vendit të lire të kategorisë së ulët drejtuese, për pozicionin:

**• 1 (një) Përgjegjës në Sektorin e Financës dhe Buxhetit në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve – Kategoria III-1.**

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është vakant, ai është i vlefshëm për nëpunësit civilë nga kategoria paraardhëse për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë ku mund të marrin pjesë për konkurim edhe kandidatët nga jashtë shërbimit civil që plotësojnë kriteret e posaçme dhe të përgjithshme të listuara në shpallje. Për çdo procedurë aplikohet në të njëjtën kohë!

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR LËVIZJE PARALELE: 19.02.2024

DATA E DORËZIMIT TË DOKUMENTAVE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL:  
22.02.2024

**Përshkrimi i punës:**

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- Harton dhe ndjek projektbuxhetin vjetor dhe bilancin vjetor, si dhe raportimin e aktivitetit ekonomik – financiar të AMA-s të paraqitur në raportin vjetor;
- Harton bilancin kontabël të Institucionit sipas periudhave kohore të përcaktuara dhe në përputhje me kriteret sipas dispozitave ligjore;
- Mbikqyr shfrytëzimin me efektivitet të burimeve financiare;

- d) Mbikqyr dhe ndjek mbajtjen e llogarive të të ardhurave dhe shpenzimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- e) Mbikqyr dhe ndjek realizimin e buxhetit sipas limitit të miratuar dhe paraqitja e tyre nëpërmjet pasqyrave financiare.
- f) Ndjek regjistrimet e subjekteve private të licencuara në organet tatimore duke vepruar si agjent tatimor konform dispozitave për ligjet fiskale.
- g) Krijon dhe azhuron skedarin e të dhënave ekonomike të deklaruara në bilancet kontabël të subjekteve audio/audiovizive. Mban për përdorim të brendshëm të institucionit në mënyrë të grupuar të dhënat ekonomike të përpunuara të subjekteve audio/audiovizive.
- h) Kontrollon praktikën për pagesën e të gjitha llojeve të shpenzimeve/investimeve dhe ia paraqet Drejtorit.
- i) Mbikqyr dhe koordinon veprimtarinë e Sektorit mbi vlerësimin e kriterëve ekonomik – financiar të përcaktuara në rregulloret e miratuara nga AMA, gjatë shqyrtimit të propozimeve dhe aplikimeve për ushtrimin e shërbimeve të transmetimit, përfshirë aplikimet për transmetime numerike dhe autorizimet /licencat përkatëse;
- j) Mbikqyr dhe koordinon veprimtarinë e regjistrimit dhe kontabilizimit të dokumentacionit në lidhje me detyrimet financiare të subjekteve për transmetim audio/audiovizive për AMA-n;
- k) Mban kontabilitetin e institucionit dhe anekset të tij konform ligjit për kontabilitetin;
  - a) Administron librin e pagave të punonjësve të institucionit sipas listë pagesave;
  - b) Administron dhe mbikqyr dosjet e OSHMA-ve me llogaritjet e detyrimeve të pagesave mbi bazën e zonave të licencimit dhe popullsisë së mbuluar dhe ndjek në vazhdimësi shlyerjen e detyrimeve të tyre.
  - c) Administron librin e arkës së veprimeve të kryera konform dokumentacionit përkatës për aktivitetin e brendshëm financiar të institucionit;

## I.Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

### I.1- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta:

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimin e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Të plotësojë kushtet dhe kërkesat e posaçme, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” në Shkenca Ekonomike-Financë. Edhe diploma e nivelit “Bachelor” të jetë në të njëjtën fushë;
- Të ketë mbi dy vjet eksperiencë pune në nivel të ulët drejtues;
- Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

## **I.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të institucionit dokumentet si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron;
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- d) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- f) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- g) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- h) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- i) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- j) Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- k) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- l) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 19.02.2024.

## **I.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:**

Pas datës 19.02.2024, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

## **I.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Ligjin Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”;

- Njohuri mbi “Kodin e Procedurave Administrative”;
- Njohuritë mbi Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2020, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar.

### **I.5- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen për dokumentacionin, përkatësisht për eksperiencat (20 pike), trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën (10 pike), si dhe vlerësimet pozitive (10 pike). Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

### **I.6- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti Mediave Audiovizive do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AMA-s. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

## **II- Ngritja në detyrë / Pranimi nga jashtë shërbimit civil**

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë apo pranimit nga jashtë për kategorinë e ulët drejtuese.

### **II.1-Kërkesat e përgjithshme**

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë janë:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar;
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë vlerësimet e fundit “Mirë” apo “Shumë mirë”;
- Niveli i diplomës duhet të jetë “Master Shkencor”. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit “Master Shkencor” për “Shkenca ekonomike-Financë”. Edhe diploma e nivelit Bachelor të jetë e të njëjtës fushë.
- Të kenë mbi 2 vjet përvojë pune në pozicione të kategorisë ekzekutive;
- Të ketë mbi 5 vite përvojë pune në fushën përkatëse në profesion (për nëpunësin jashtë shërbimit civil)

- d) Të ketë aftësi për të ofruar drejtim profesional, për të planifikuar, koordinuar, kontrolluar dhe vlerësuar veprimtarinë dhe përdorimin e burimeve në dispozicion.
- e) Aftësi shumë të mira komunikimi dhe prezantimi.

## **II.2- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit**

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Mediave Audiovizive si më poshtë:

- a) Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron;
- b) Jetëshkrim
- c) Fotokopje të diplomës;
- ç) Fotokopje të librezës së punës; (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- dh) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- g) Vlerësimin e fundit nga eprorit direkt;
- gj) Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaj;
- h) Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- j) Aktin e fundit të emërimit në pozicionin aktual, në të cilin të përcaktohet edhe kategoria e pozicionit, ose në pamundësi një vërtetim nga institucioni lidhur me pozicionin aktual të kandidatit dhe kategorinë përkatëse.

## **II.3- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak:**

Pas datës 22.02.2024, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, për procedurën e pranimit në kategorinë e ulet drejtuese, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet konkursi. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e ngritjes në detyrë dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit nëpërmjet adresave të e-mail, për shkaqet e mos kualifikimit.

## **II.4- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkursi:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuri në lidhje me Ligjin 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me ligjin 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Njohuri në lidhje me Kodin e Procedurave Administrative;
- Ligj nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Ligji nr.9131, datë 8.9.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”

## **II.5 Mënyra e vlerësimit të kandidatëve:**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Vlerësimin me shkrim, deri në 40 pikë;
- Intervistën e strukturuar me gojë deri në 40 pikë;
- Dokumentacioni i dorëzuar deri në 20 pikë

## **II.6 - Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore do të shpallë fituesin në faqen elektronike të AMA-s dhe në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email).

Adresa: Autoriteti Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë